



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 17 tetor 2017

Numri i lëndës: 2016-05

Axhemi Zyhdi

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 17 tetor 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar në Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) me datën 22 mars 2016. Paneli ka njoftuar shefen e Misionit (ShM), EULEX-in Kosovën, lidhur me këtë ankesë me 23 mars 2016.

II. FAKTET

2. Faktet e lëndës të paraqitura nga ankuesi mund të përmblidhen si më poshtë:

3. Ankuesi ka publikuar një fjalor Anglisht-Shqip-Serbisht - Fjalor i terminologjisë së doganave në fund të vitit 2005 - fillimi i vitit 2006.
4. Komponenti për doganë i UNMIK-ut (Shtylla IV) ka financuar shtypjen e 850 kopjeve të fjalorit në fjalë bazuar në një "marrëveshje gojore" ndërmjet ankuesit dhe UNMIK-ut. Në pajtim me këtë marrëveshje, ankuesi ka mbajtur për vete 250 kopje dhe pjesën e mbetur prej 600 kopjesh ia ka dorëzuar UNMIK-ut.
5. Ankuesi pohon se pas kësaj nuk kishte dhënë leje ose nuk kishte hyrë në ndonjë marrëdhënie kontraktuale me ndonjë subjekt, për ndonjë publikim të mëtejshëm të punës së tij në çfarëdo forme, qoftë në formë elektronike ose tjeter.
6. Megjithatë, fjalori ishte botuar në faqen zyrtare të EULEX-it diku në vitin 2009 (www.eulex-kosovo.eu).
7. Me 26 janar 2011, ankuesi i ka shkruar EULEX-it me qëllim që të kërkonte kompensim monetar në shumën prej 10,000 eurosh nga EULEX-i për publikimin dhe përdorimin e fjalorit në faqen e internetit të EULEX-it.
8. EULEX-i ishte përgjigjur me 11 mars 2011 se çështja i ishte referuar zyrtarit për EULEX-in, Komisionit Evropian, Bruksel, për shqyrtimin e kërkësës së tij për kompensim.
9. Më vonë, EULEX-i ka informuar ankuesin se Komisioni Evropian kishte vendosur që EULEX-i nuk kishte pasur ndonjë përfitim ekonomik prej vendosjes së përkohshme të fjalorit në faqen e vet të internetit dhe as ankuesi nuk kishte ofruar ndonjë dëshmi EULEX-it se ai kishte pësuar ndonjë dëm material si rezultat i këtij publikimi. Më tej EULEX-i ka deklaruar se nuk kishte dëshmi të qartë se EULEX-i "kishte shfrytëzuar punën (fjalorin) gjatë aktivitetit të vet të përditshëm" dhe vuri në dukje se fjalori ishte hequr menjëherë nga faqja e internetit të EULEX-it sapo çështja ishte bërë e njohur. Në përfundim, EULEX-i ka deklaruar se "duke mos dëshiruar të hedh poshtë çfarëdo kërkese të ligjishme të parashtruar nga ju, Komisioni nuk gjen arsy që pagesa të bëhet tanë".
10. Nuk kishte komunikim të mëtejshëm ndërmjet ankuesit dhe EULEX-it që nga momenti kur ai e mori letrën nga EULEX me datën 11 mars 2011.

III. ANKESA

11. Ankuesi ka pretenduar se EULEX-i nuk i ka paguar atij kompensim monetar në shumën prej 10,000 eurosh në lidhje me kërkësën e tij të parashtruar në EULEX me datën 26 janar 2011 lidhur me publikimin në vitin 2009 të një fjalori në faqen e tij të internetit nga EULEX-i. Përderisa ai nuk identifikon në mënyrë të veçantë ndonjë të drejtë themelore që thuhet se është shkelur, duket nga mënyra e ankesës së tij se kjo ka të bëjë me gjëzimin paqësor të pasurisë së tij të mbrojtur, *ndër të tjera* sipas

nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

IV. LIGJI

12. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrotjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standartet minimale për mbrotjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
13. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës.
14. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1, i rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në gjyqësi, polici dhe dogana. Sipas rregullës 25 (3) të rregullores së punës së Panelit, ankesa duhet të parashtronet në Panel brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së pretenduar.
15. Kjo ankesë ka të bëjë me kërkesën e ankuesit për kompensim nga ana e EULEX-it. Ankuesi ka parashtruar kërkesën e tij për kompensim në EULEX me datën 26 janar 2011. EULEX-i ishte përgjigjur ankuesit me 11 mars 2011, duke refuzuar që të paguante kompensimin. Ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi rrëth ndonjë komunikimi të mëtejshëm ndërmjet tij dhe EULEX-it pas kësaj date. Ankesa e tij ishte parashtruar në Panel me datën 22 mars 2016, më shumë se pesë vjet pas refuzimit të kompensimit.
16. Paneli thekson se rrjedhimisht sjellja për të cilën është bërë ankesa nga ana e ankuesit bie jashtë afatit gjashtë mujor, ku brenda këtij afati ankesa duhet të parashtronet në Panel (rregulla 25(3) i rregullores së punës së Panelit).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se ankesa duhet të refuzohet në përputhje me rregullën 29 (c), pasi ajo ishte parashtruar jashtë afatit, dhe prandaj

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese